



Masat e marra nga Banka e Shqipërisë për riskedulimin e kësteve të kredisë hyjnë në fuqi në datën 13 mars 2020 dhe zgjasin deri në datën 31 maj 2020.

Gjatë kësaj periudhe, ata kredimarrës, individë dhe biznese, gjendja financiare e të cilëve përkeqësohet nga situata aktuale, mund të përfitojnë një shtyrje, deri në 3 muaj, të pagesave të kësteve të kredive të tyre, të marra nga institucionet financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë si banka, jobanka dhe shoqëri kursim-krediti.

Procesi bën të mundur vetëm **riskedulimin e detyrimeve të kredimarrësve, por jo falje të tyre.**

Kredimarrësit duhet të kontaktojnë me institucionin financiar (bankë, jobankë, shoqëri kursim-krediti) me të cilin kanë marrëdhënien e kreditimit dhe të bëjnë kërkesë për riskedulim të kësteve të kredisë.

Institucioni financiar (banka, jobanka, shoqëria e kursim-kredititi), në bashkëpunim me kredimarrësin, do të vlerësojë kërkesën dhe, bazuar në specifikat e rastit, do të ofrojë edhe zgjidhjen përkatëse.

Kredimarrësit, aftësia paguese e të cilëve nuk preket apo dëmtohet nga kjo situatë duhet të vijojnë normalisht shlyerjen e detyrimeve të tyre me këto institucione.



Measures taken by the Bank of Albania to reschedule loan installments enter into force on 13 March 2020 and last until 31 May 2020.

During this period, those borrowers, individuals and businesses, whose financial situation is deteriorated from the current situation, may benefit from a delay of up to 3 months in paying the installments of their loans received from the licensed financial institutions by the Bank of Albania, i.e. banks, non-bank financial institutions, and savings and loan associations.

The process only makes possible to **reschedule the borrowers' obligations, but does not constitute a waiver of such obligations.**

Borrowers should contact the financial institution (bank, non-bank financial institutions, savings and loan association) they have a credit relationship with and make a request for the rescheduling of the loan installments.

The financial institution (bank, non-bank financial institution, savings and loan associations), in cooperation with the borrower, will evaluate the request and, based on the specifics of the case, will provide the appropriate solution.

Borrowers whose solvency is not affected or impaired by this situation should normally continue to discharge their obligations with these institutions.